

EULEX-i Shtylla e Parë (e re) e UNMIK-ut

Hyrje

Më 9 dhjetor filloi punën misioni i ri ndërkombëtar në Kosovë – mision ky që do të vazhdojë ta mbajë pushtetin ekzekutiv në ushtrimin e dhunës ligjore në Kosovë. Në vendin tonë të cilit po i themi i pavarur. Më 7 janar të vitit 2008, më shumë se një muaj para se Deklarata e pavarësisë së Kosovës të shpallet në Kuvend, Janez Jansha, kryeministër i Sllovenisë, në kohën kur vendi i tij kryesonte BE-në, kishte thënë se Kosova nuk do të jetë e pavarur meqenëse “një mision të tillë evropian ne nuk do ta dërgonim në një vend tërësisht të pavarur, në një vend sovran.” (Radio Evropa e Lirë, 7 janar 2008; Ahto Lobjakas; <http://www.rferl.org/content/article/1079326.html>).

Kjo përgjigje e tij kishte ardhur para shpalljes së pavarësisë. Mirëpo çka e bënte atë tërësisht të sigurt për mangësinë e sovranitetit dhe shtetësisë së plotë të Kosovës (përveç Planit të Ahtisaarit dhe koordinimit të Deklaratës së Pavarësisë, të cilat Jansha i njëjti më mirë se populli i Kosovës) ishte edhe një dokument tjetër – Veprimi i Përbashkët i Këshillit të BE-së (Këshill ky që kryesohej nga Jansha), dokument ligjor që e themelonte EULEX-in.

Mundësimi i EULEX-it pamundësonte pavarësinë. Këtë e mendonte Jansha atëherë.

Këtë e thoshte Lëvizja VETËVENDOSJE! prej fillimit. Shteti i pavarur dhe sovran nuk duron misione të huaja me pushtet ekzekutiv brenda.

Misioni i EULEX-it, i vetëm pa Përfaqësuesin Civil Ndërkombëtar, do t'i kushtojë Bashkimit Evropian gjithsej 364 milionë për vitin e parë dhe nga 400 milionë për vitet pas tij. Po të ishte vërtetë përqendrimi në ndihmë për Kosovën, atëherë kjo shumë parash do të ishte mjaft e madhe për t'u përdorur në ato sfera të jetës shoqërore ku Kosova ka shumë më shumë nevojë, dhe ku populli i Kosovës do të kishte vërtetë dobi. Me këto para BE do të mund të ndërtonte universitete të nivelit më të lartë, spitale me standarde vërtetë evropiane, infrastrukturë fizike dhe ekonomike.

Të gjitha këto do t'ia përmirësonin cilësinë e jetës qytetarit të Kosovës, dhe do t'ia hapnin rrugën Kosovës për zhvillim e përparim. Këto do të ishin ndihmë e pakontestueshme në ndërtimin e një shteti të pavarur. Por jo, këto miliona euro janë ndarë për të financuar policë, gjykatës e prokurorë – elemente të aparatit të dhunës. Ndihej është e tillë vetëm nëse bëhet në bazë të nevojave të përcaktuara nga ne dhe në fusha të identifikuar nga ne. Përndryshe ajo është imponim që nuk na zhvillon por na pengon.

Rezoluta 1244

Veprimi i Përbashkët i Këshillit të BE-së (VPKBE) ishte miratuar më 4 shkurt. Arkitekti kryesor i VPKBE, Javier Solana, ishte i interesuar ta ketë atë të gatshëm para se të shpallej pavarësia në mënyrë që ftesa që do t'i bëhej EULEX-it nga institucionet e Kosovës, t'i bëhej një misioni të paradisenjuar. Për më tepër një misioni i cili bazën ligjore të tij do ta ndërtonte në dokumente që e pamundësojnë pavarësinë e Kosovës (Rezoluta 1244), e jo në dokumente ligjore të cilat mund të rrjedhin pas Deklaratës së Pavarësisë, madje as në të. Po të kishte qenë qëllimi i BE-së që ta disenjonte një mision në bazë të nevojave të Kosovës, për t'i përbushur siç po na thuhet rrejshëm ato vrima në sundimin e ligjit të cilat nuk do të mbushen dot nga institucionet vendore, atëherë BE-ja do të priste ta disenjonte atë pas pavarësisë dhe bashkë me institucionet sovrane të Kosovës, në bazë të kërkesave të tyre.

Kështu siç është vepruar, disenjimi i misionit para shpalljes e hedh poshtë edhe shpalljen edhe mundësinë që Kosova të ketë institucione sovrane. Deklarata e Pavarësisë e thërret një mision të sundimit të ligjit të udhëhequr nga Bashkimi Evropian (EULEX) në pikën 5 të saj, përderisa Veprimi i Përbashkët i Këshillit të BE-së askund nuk e përmend Kosovën si shtet. Kjo nënkupton që institucionet e Kosovës e kanë ftuar një mision që nuk na njeh.

Por jo vetëm kaq. Institucionet e Kosovës e kanë ftuar një mision i cili nuk mund të na njuh, për shkak se bazohet në Rezolutën 1244, e cila Kosovën e konsideron si pjesë të integritetit territorial dhe sovranitetit të Serbisë (nën administrim të përkohshëm ndërkombëtar). Kjo rezolutë në Nenin 10 e autorizon Sekretarin e Përgjithshëm të OKB-së që ta themelojë Pranimin Civil Ndërkombëtar për administrim të përkohshëm në bazë të të cilit njerëzit në Kosovë mund të gëzojnë autonomi substanciale brenda Republikës Federale të Jugosllavisë, dhe të ofrojë administratë kalimtare deri në themelimin e institucioneve kalimtare demokratike të Kosovës të cilat do të sigurojnë jetë normale dhe të qetë për të gjithë banorët e Kosovës.

Këtij Neni i referohet Veprimi i Përbashkët i Këshillit të BE-së. Njëkohësisht VPKBE e thërret edhe Nenin 11 të Rezolutës përmes të cilit kërkohet nga prania civile që të mbikëqyr transferimin e autoritetit nga institucionet kalimtare të Kosovës në institucionet e Kosovës, të cilat themelohen në bazë të marrëveshjes politike, dhe të mbajë rendin dhe ligjin civil duke themeluar forca lokale policore dhe, në ndërkohë, përmes zbakimit të policëve ndërkombëtarë, të cilët do të shërbejnë në Kosovë.

Për EULEX-in Kosova është në vitin 1999. Po ta njihje Kosovën shtet të pavarur dhe sovran EULEX-i tashmë do ta kuptonte se institucionet e Kosovës janë themeluar dhe se nuk ka nevojë për policë ndërkombëtarë. Por jo. Sipas dokumentit në fjalë për EULEX-in institucionet e Kosovës me të cilat ai do të ketë punë, mes tjerash, janë institucionet për rendin dhe ligjin të krijuara në bazë të Rezolutës 1244 (Shërbimi Policor i Kosovës, gjyqësia e UNMIK-ut, Shërbimi Doganor i Kosovës, etj.) EULEX-i, që nga dita e parë e ekzistimit të tij në letër, është menduar të jetë mision në kuadër të Rezolutës 1244.

Në tërë këtë lëmsh juridiko-politik ka më shumë se një interpretim. Korniza ligjore është lënë qëllimisht e shumëkuptimtë. Meqenëse Kosova po konsiderohet si rast sui generis hierarkia e qartë juridike që vlen për vendet tjera jo domosdoshmërisht do të vlejë edhe për ne. Ne nuk jemi si të tjerët. Prandaj këtu nuk mund të thuhet me siguri të plotë se Kushtetuta e vendit do të jetë ligj mbi ligjet, për shkak se mbi të janë Plani i Ahtisaarit (që po vlen për ne edhe pse jo për të tjerët), e mbi to edhe Rezoluta 1244 që është në kundërshtim thelbësor me Kushtetutën. Edhe këtu nuk mund të thuhet me siguri të plotë kur apo ku EULEX-i do t'i zbatojë ligjet e Kosovës e kur rregulloret e UNMIK-ut.

Mirëpo është e qartë se edhe nëse një gjykatës i EULEX-it do ta dënojë një shqiptar duke u bazuar në ligjet e Kosovës, ky gjykatës nuk do ta njuh gjykatën të cilën e kryeson si gjykatë të Republikës së Kosovës. Ai nukdo të betohet në emër të Republikës së Kosovës dhe nuk do t'i jep llogari në asnjë mënyrë institucioneve të Republikës së Kosovës.

Këtu çdo gjë do të varet nga interpretimi, apo thënë më saktë nga interpretuesi. E interpretuesi do të jetë EULEX-i, e jo institucionet e Kosovës e aq më pak populli i Kosovës. Prandaj në deklaratimet e tij publike Yves de Kermabon përdorë përgjigje të prera, me siguri formale e objektive të llojit "Ne jemi këtu sipas Rezolutës 1244", përderisa kërkon institucional flasin më shumë për besimin e tyre personal subjektiv të llojit "Ne besojmë se do të shtrihemi në tërë territorin e Kosovës". Për shkak se sovraniteti po mbetet në duart e tjetrit.

Në raportin e Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së të paraqitur para Këshillit të Sigurimit më 24 nëntor 2008, i cili merret tërësisht parasysh në Deklaratën Presidenciale dhe që i hap rrugën zbakimit të EULEX-it, Ki-moon thotë se: "Pres nga EULEX-i që të ecën para me zbakimin në periudhën e ardhme dhe t'i marrë përgjegjësitë në fushën e policisë, gjykatave dhe doganave, nën autoritetin e përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, nën ombrellën e Kombeve të Bashkuara të kryesuar nga Përfaqësuesi im Special, dhe në përputhshmëri me Rezolutën 1244 (1999)." (X.23 Rikonfigurimi i UNMIK-ut).

Neutral karshi statusit

EULEX-i do të jetë neutral karshi statusit. Në pikën XII. Observimet, të raportit të Sekretarit të Përgjithshëm, 24 nëntor 2008, Ki-moon thotë: “Sipas udhëzimeve të mia, Përfaqësuesi im Special dhe Kreu i UNMIK-ut është duke i lehtësuar përgatitjet e Bashkimit Evropian për të ndërmarrë një rol operacional në Kosovë në fushën e sundimit të ligjit. EULEX-i do ta respektojë në tërësi Rezolutën 1244 (1999) dhe do të operojë nën autoritetin e përgjithshëm përbrenda kornizës neutrale të OKB-së ndaj statusit.”

Kjo nënkupton se personeli i EULEX-it i cili do të punojë në vendkalimet kufitare 1 dhe 31 do ta konsiderojnë kufirin me Serbinë si Vijë Administrative Kufitare e jo kufi të Kosovës me Serbinë. Kështu siç po e trajton Serbia. Në pikën XI të titulluar Dialogu me Serbinë të të njëjtit raport thuhet se doganierët ndërkombëtarë të emëruar sipas Rezolutës 1244 (1999) do të vendosen në pikat 1 dhe 3.

Pushteti ekzekutiv

Sa herë që flasin në media përfaqësues të EULEX-it thonë se këtu do të kenë vetëm rolin e mentorit, monitoruesit dhe këshilltarit. Kjo është rrenë. Ata do ta kenë edhe një rol, që është më i rëndësishmi për ta, dhe për të cilin në të vërtetë janë duke ardhur: atë të përgjegjësisë ekzekutive. Këtë e kanë pjesë të Deklaratës së Misionit të tyre (Mission Statement), që është Neni 2 i VPKBE-së. Në Nenin 3 të VPKBE-së i cili i definon detyrat e EULEX-it, pika (d) flet për të gjitha ato raste të cilat do të hetohen nëse është nevojë pavarësisht nga zyrtarët vendorë. Ndërkohë që i njëjti nen përmes pikës (b) ia lejon EULEX-it ndërhyrjen arbitrare në punën e institucioneve të Kosovës, duke i dhënë pushtet atij të prapakthejë apo anulojë çfarëdo vendimi operacional të marrur nga autoritetet kompetente të Kosovës.

Përderisa EULEX-i do të ketë të drejtë të veprojë pavarësisht nga autoritetet e Kosovës (dhe jashtë tyre) në disa raste specifike, si dhe të merr përgjegjësi shtesë, prapë pavarësisht apo në përkrahje të institucioneve të Kosovës (pika (h)), autoritetet e Kosovës duhet t’ia përshtasin secilin vendim operacional EULEX-it. Kush është i pavaruri këtu? EULEX-i nuk është mision që do ta mbikëqyrë pavarësinë e Kosovës – ai është mision tërësisht i pavarur nga Kosova të cilën e kanë varur në të.

EULEX-i po vjen në Kosovë përbrenda Planit 6 pikësh, të cilin Ban Ki-moon në raportin e tij e ka titulluar Dialogu me Beogradin, dhe për ta zbatuar atë. Pjesa nën A e kësaj pjese të raportit që ka të bëjë me policinë thotë: “Të gjitha aktivitetet policore në Kosovë do të jenë të monitoruara ndërkombëtarisht, siç jemi marrë vesh nën aranzhimet e tashme dhe aranzhimet për të ardhmen. Monitoruesit policor ndërkombëtarë do të vendosen në të gjitha stacionet dhe nënstacionet policore, në të gjitha rajonet dhe departamentet. Këta monitorues do të kenë strukturë të pavarur komanduese që aktualisht përfundon në Përfaqësuesin tim Special.”

Për sa i përket doganave në pjesën B, pika 36 thotë se oficerët ndërkombëtarë doganor do të vendosen në vendkalime kufitare 1 dhe 31. Ata do të aplikojnë procedura që janë në përputhje me Rezolutën 1244, përfshirë protokolin mes Administratës Tatimore të Serbisë dhe Shërbimit Doganor të UNMIK-ut.

Në Kapitullin X që titullohet “Rikonfigurimi i UNMIK-ut”, pika 24, tregohet që “...Departamenti i drejtësisë së UNMIK-ut ka vendosur parimet për të mundësuar qasje për prokurorët e EULEX-it në dosjet e rasteve të marrura nga prokurorët ndërkombëtarë dhe prokurorët specialë. Qasja në materialet policore lidhur me hetime penale të caktuara tek komponentja policore e EULEX-it është bërë në bazë të një aranzhimi të ngjashëm i dakorduar në shtator.” Pra, Rikonfigurimi i UNMIK-ut është zëvendësimi i Shtyllës së parë të UNMIK-ut me EULEX-in.

EULEX-i do të bashkëpunojë me strukturat ilegale të Serbisë të dala nga zgjedhjet e 11 majit 2008 dhe kështu t’i legjitimojë ato XII. Observime, Raporti i Sekretarit të Përgjithshëm për UNMIK-un, 24 nëntor 2008 50. Zbarkimi i EULEX-it gjithandej në Kosovë do të bëhet në konsultime të ngushta me hisedarët relevantë, duke marrë parasysh rrethanat specifike dhe brengat e të gjitha komuniteteve, dhe do të bashkërendohet me UNMIK-un.

Mandati

1. Veprimi i Përbashkët i Këshillit të BE-së 5928/08

- EULEX-i është autorizuar të veprojë në Kosovë në përputhje me Rezolutën 1244 për:
- 'Mbikëqyrjen e transferimit të autoritetit prej institucioneve të përkohshme të Kosovës te institucionet e themeluara sipas marrëveshjes politike'
- 'Zbatimin e ligjit civil dhe mbajtjen e rendit, përfshirë krijimin e forcave policore vendore, dhe në ndërkohë, përmes dislokimit të personelit policor ndërkombëtar për të shërbyer në Kosovë' (Preambula, 1)
- EULEX-i është themeluar si 'operacion për menaxhimin e krizave' nga BE-ja për ta forcuar 'stabilitetin'
- 'Ka nevojë për t'i parandaluar, në bazë humanitare, shpërthimet e mundshme të dhunës, aktet e përndjekjes dhe frikësimit në Kosovë' (Preambula, 3)
- 'Më 11 dhjetor të vitit 2006, Këshilli ka miratuar Konceptin e Menaxhimit të Krizave për operacionin e mundshëm të BE-së për menaxhimin e krizave në fushën e sundimit të ligjit dhe fushat e tjera të mundshme në Kosovë' (Preambula, 5)
- Misioni është pjesë e politikës së BE-së për ta 'luajtur rolin kryesor në forcimin e stabilitetit në rajon' (Preambula, 7)
- EULEX-i 'do të ndërhyjë në situatat që mund t'i përkeqësojnë apo dëmtojnë objektivat e Politikës së Jashtme dhe të Sigurisë' (Preambula, 14)
- EULEX-i do t'i monitorojë, udhëzojë dhe këshillojë institucionet e rendit dhe të ligjit në Kosovë.
- EULEX-i do ta 'përbush mandatin e tij përmes monitorimit, udhëzimit dhe këshillimit, ndërkohë që do t'i mbajë disa përgjegjësi ekzekutive' (Neni 2)
- Ai do të ndihmojë në 'përkujdesjen që këto institucione të jenë të lira nga ndërhyrjet politike dhe t'i përmbahen standardeve të pranuar ndërkombëtarisht dhe praktikave më të mira evropiane' (Neni 2)
- Ai do të kujdeset që 'rastet e krimeve të luftës, terrorizmit, krimit të organizuar, korrupsionit, krimit ndëretnik, krimit financiar/ekonomik dhe krimeve tjera serioze të hetohen, ndiqen, gjykohen dhe sforcohen me rregull', dhe, kur është e përshtatshme, nga zyrtarë ndërkombëtarë me autoritetet e Kosovës apo pavarësisht nga to (Neni 3.d)
- EULEX-i do të përbëhet nga misioni i policisë, ai i gjyqësisë si dhe misioni i doganave, që do të veprojnë brenda institucioneve të Kosovës, e që janë pjesë e një misioni të përbashkët të PESH-së (Neni 6). Personeli do të vendoset Brenda Shërbimit Policor të Kosovës, ministrive relevante, gjyqësisë, Agjencisë Kosovare të Pronës, Shërbimit Korrektues të Kosovës dhe Shërbimit Doganor të Kosovës.
- EULEX-i do të ketë të drejtë ta përdorë pushtetin ekzekutiv

- Do të 'kujdeset për mbajtjen dhe promovimin e sundimit të ligjit, rendit publik dhe sigurisë, përfshirë këtu përmes prapaktimit apo anulimit të vendimeve operacionale të marrura nga autoritetet kompetente të Kosovës, siç është nevoja dhe pas konsultimit me autoritetet relevante civile ndërkombëtare në Kosovë,' (Neni 3.b)
- EULEX-i ka të drejtë të 'marrë mbi vete përgjegjësi tjera, pavarësisht apo në përkrahje të autoriteteve kompetente të Kosovës, për të siguruar mbajtjen dhe promovimin e sundimit të ligjit, rendit publik dhe sigurisë, pas konsultimit me agjencitë relevante të Këshillit' (Neni 3.h)

2. Pushteti dhe Përgjegjësitë: Marrëveshja e Ahtisaarit, Aneksi IX

Sipas Aneksit IX të Planit të Ahtisaarit, EULEX-i i ka kompetencat e poshtëshënuara, të cilat i ushtron nën udhëzimin e PSBE/PCN-së.

Sistemi ligjor (Neni 2.3)

Ka autoritetin që të kujdeset që rastet e krimeve të luftës, terrorizmit, krimin të organizuar, korrupsionit, krimin ndëretnik, krimin financiar/ekonomik, rastet që kanë të bëjnë me pronën dhe krimet tjera serioze do të hetohen, ndiqen, gjykohen dhe se vendimet do të zbatohen me rregull. Hetimet mund të bëhen nga hetuesit, prokurorët ose gjykatësit ndërkombëtarë, që veprojnë bashkërisht me autoritetet e Kosovës, apo pavarësisht nga to (Neni 2.3a,b,c,d)

Kreu i EULEX-it ka të drejtë të përcaktojë kritere sipas të cilave do të përzgjedhen rastet për prokurorët dhe gjykatësit ndërkombëtarë (Neni 2.3, b,c)

EULEX-i ka autoritetin të monitorojë, udhëzojë dhe këshillojë në të gjitha fushat që kanë të bëjnë me sundimin e ligjit (Neni 2.3g)

Kufizime të padefinuara të pushtetit të sigurisë

EULEX-i ka autoritetin të marrë mbi vete përgjegjësi tjera, pavarësisht apo me përkrahje të autoriteteve kompetente të Kosovës, për të siguruar mbajtjen dhe promovimin e sundimit të ligjit, rendit publik dhe sigurisë (Neni 2.3 e). Nuk është qartësuar nëse ky pushtet do të përdoret vetëm në raste emergjente apo do të jetë proces standard i qeverisjes.

Pushteti korrektues

Në konsultim me PCN-në, EULEX-i ka autoritetin t'i prapakthejë apo anulojë vendimet operacionale të marra nga autoritetet kompetente të Kosovës, për t'u siguruar mbajtja dhe promovimi i sundimit të ligjit, i rendit publik dhe sigurisë; (Neni 2.3f)

Llogaridhënia

Në Deklaratën e Misionit, Neni 2, thuhet që EULEX-i "do t'i asistojë institucionet e Kosovës, autoritetet gjyqësore dhe agjencitë për zbatimin e ligjit në progresin e tyre drejt qëndrueshmërisë dhe llogaridhënies...". EULEX-i nuk jep llogari poshtë por vetëm lart tek Javier Solana. Pra, edhe institucioneve tona ai mund t'iu asistojë vetëm për llogaridhënie lart (sic.). Në këtë Deklaratë të Misionit por as në vijim nuk shpjegohet qartë pse i duhen fuqitë ekzekutive EULEX-it.

EULEX do të operojë nën autoritet të ndarë:

Në nivelin më të lartë, do t'i jep llogari BE-së (Solanës), por edhe OKB-së (Sekretarit të Përgjithshëm).

Në nivelin e Kosovës, nga EULEX-i kërkohet që të konsultohet me PCN/PBE-së kur e përdor pushtetin e vet ekzekutiv. Po ashtu kërkohet nga EULEX-i që t'i raportojë PSSP-së për detyrat policore në zonat minoritare.

EULEX-i i jep llogari OKB-së:

- XII. Observimet, Raporti i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së për UNMIK-un, 24 nëntor 2008
- 50. "EULEX-i rregullisht do të dërgojë raporte në OKB"
- EULEX-i i jep llogari BE-së, të personifikuar nga Sekretari i Përgjithshëm/Përfaqësuesi i Lartë, Javier Solana
- EULEX-i është nën kontrollin politik dhe drejtimet strategjike të tre organeve të BE-së.
- Komanda strategjike dhe kontrolli i EULEX-it e ka selinë në Bruksel në të ashtuquajturën Kapaciteti Civil për Planifikim dhe Drejtim (KCPD). Komanduesi Civil i Operacionit të KCPD-së është Kees Klompenhauer.
- KCPD-ja vepron nën autoritetin e Komitetit të BE-së për Politikë dhe Siguri (KPS) dhe nën autoritetin final të Javier Solana, SP/PL. (Neni 7)
- Këshilli i BE-së vendos, nën rekomandimet e Solanës, se kur do të përfundojë misioni i EULEX-it. (Neni 12.2)
- Komanduesi Civil i Operacionit, Klompenhauer, i ofron këshilla dhe përkrahje teknike kreut të misionit, Yves de Kermabon (Neni 7.2 VPKBE)
- Kreu i misionit, Yves de Kermabon, komandon dhe kontrollon personelin dhe resurset e EULEX-it (Neni 8)
- Komanduesi Civil i Operacionit, Klompenhauer dhe PSBE-së (Pieter Feith) duhet ta konsultojnë njëri-tjetrin siç kërkohet (Neni 7.6)
- Kreu i misionit, Yves de Kermabon merr udhëzime për politikën lokale nga PSBE-ja përsa i përket aspektit politik të përdorimit të pushtetit ekzekutiv (Neni 8.8)
- Veprimi i Përbashkët i Këshillit të BE-së i cili e emëron Pieter Feith-in si Përfaqësues të BE-së/PCN (5576/1/08) 12 shkurt 2008 thotë që Përfaqësuesi i BE-së mund t'i jep udhëzime politike EULEX-it (Neni 3)

Imuniteti

Të gjithë të punësuarit e EULEX-it, përfshirë familjet e tyre, zyret dhe arkivat e tyre, kanë imunitet diplomatik.

Kosova do t'ia jep zyrës së PCN-së dhe PSBE-së, si dhe objekteve të tyre, arkivave, dhe pronës tjetër, si dhe anëtarëve profesionalë të stafit të tij, përfshirë familjet e tyre, si dhe atyre profesionistëve ndërkombëtarë të emëruar nga PCN-ja privilegjet dhe imunitetet e njëjta me ato që gëzohen sipas Konventës së Vjenës për Marrëdhëniet Diplomatike (KVMD) (Neni 4.6 (a,b,c) Aneksi IX).

KVMD thotë që imuniteti diplomatik nuk i përjashton zyrtarët nga juridiksioni i vendeve prej nga vijnë, ose prej juridiksionit civil dhe administrativ të gjykatave të Kosovës, në rastet specifike që kanë të bëjnë me pronën, suksesionin dhe aktivitetin profesional ose komercial jashtë funksionit formal zyrtar (Neni 31).

KVMD ia rezervon të drejtën Qeverisë së Kosovës që 'në çdo kohë dhe pa pasur nevojë ta shpjegojë vendimin e vet, ta njoftojë shtetin dërgues se kreu i misionit ose cilido anëtar i personelit diplomatik të misionit është persona non grata, ose që cilido anëtar i misionit është i papranueshëm. Në cilindo prej këtyre rasteve, shteti dërgues, do ta kthejë prapa personin në fjalë, apo t'i pezullojë funksionet e tij brenda misionit, varësisht nga përshtatshmëria me rrethanat'. Personi mund të shpallet non grata ose i papranueshëm para se të arrijë në territorin e shtetit pranues (Neni 9).

Për personelin e EULEX-it është specifikuar që shteti apo institucioni i BE-së që e ka deleguar anëtarin e personelit, do të jenë përgjegjës për përgjigje ndaj çfarëdo kërkesë që ka të bëjë me ta. Shteti apo institucioni i BE-së në fjalë do të jetë përgjegjës për ndërmarrjen e çfarëdo veprimi kundër personit të deleguar në mision. (Neni 10.2, EULEX VPKBE) Kreu i misionit është përgjegjës për kontrollin disiplinor përmbi personelin tjetër të padeleguar (Neni 8.6, EULEX VPKBE).

Buxheti i EULEX-it

Sipas web faqes së EULEX-it, buxheti i tij për 16 muajt e parë do të jetë 205 milionë euro. Kjo do të thotë se buxheti do të jetë 12,8125 milionë euro në muaj për këtë periudhë dhe 153,75 milionë euro për vitin e parë.

Pas këtyre 16 muajve të parë, buxheti vjetor i EULEX-it do të jetë 190 milionë euro (sipas Departamentit të Shtetit të ShBA-ve). Kjo do të thotë që prej muajit të 17, buxheti i EULEX-it do të jetë 15,83 milionë euro.

Sipas kumtesës për shtyp nga konferenca e donatorëve të Kosovës, BE-ja do të shpenzojë 457 milionë euro nga buxheti i përgjithshëm 2008-2010 në EULEX dhe ZCN, dmth. 19,04 milionë në muaj.

Ky buxhet i EULEX-it vjen prej buxhetit të përgjithshëm të BE-së dhe do të përdoret për gjëra si:

- Pajisje për teknologji informative – hardware, kompjuterë, software, mirëmbajtje
- Pajisje për pilicinë – kamera, GPS
- Vetura, derivate, mirëmbajtje
- Pajisje për zyre (përfshirë këtu p.sh. printerë, makina fotokopjuese etj.) dhe mirëmbajtje
- Sigurim për mjete (makina, pronë etj.)
- Uniforma dhe 'mjete të tjera të dukjes'
- Furnizime statike – qiraja, zyrat, parkingu etj.

Stafi i kontraktuar – përfshin rojet e sigurisë (që nuk do të jenë pjesë e vetë EULEX-it). Duket që edhe stafi lokal numërohet si i kontraktuar, jo kuadër i dërguar, dhe prandaj me gjasë financohet nga ky buxhet. Këtu siç duket edhe sigurimi shëndetësor për stafin e kontraktuar paguhet përmes këtij buxheti.

Si shtesë e këtij buxheti të EULEX-it (që vjen nga buxheti i përgjithshëm i BE-së) shtetet anëtare të veçanta do të financojnë shumicën dërrmuese të stafit të EULEX-it përmes dërgimit të kuadrove të tyre në mision.

Kuadrot e dërguara janë stafi i cili është dërguar dhe paguar nga shtet që marrin pjesë në misionin e EULEX-it. Shumica e shteteve anëtare të BE-së marrin pjesë në EULEX dhe dërgojnë kuadro (me numër të ndryshëm të stafit). Shtetet e tjera pjesëmarrëse janë Zvicra, Turqia, Norvegjia, ShBA-të dhe Kroacia. Kuadrot zyrtare marrin paga varësisht nga niveli i shtetit që i dërgon. Këto paga besohet që do të shërbejnë për:

- Shpenzimet e udhëtimeve për në vendin ku jetojnë dhe anasjelltas
- Mbulimi për shpenzimet shëndetësore
- Sigurimi shëndetësor
- Mëditjet (përveç mëditjeve ditore), siç janë mëditjet për punë të vështirë dhe me rrezik të lartë

Kosova është klasifikuar si ambient me rrezik të lartë. Kjo do të thotë që stafi i EULEX-it ka nevojë për sigurim për këtë rrezik të lartë (që do të paguhet nga shtetet që i dërgojnë), zyrtarët marrin edhe mëditje për vështirësitë dhe rrezikun e lartë si shtesë e rrogave të tyre, dhe po ashtu marrin pushim shtesë të detyrueshëm që të këndellen nga përditshmëria e vështirë. Ky klasifikim është në interes të zyrtarëve individualë (dmth. të atyre që raportojnë te BE-ja dhe shtetet e tyre) që të mirëmbajnë një nivel të caktuar të rrezikut dhe vështirësive këtu, një ambient të krizës, sepse kjo iu mundëson që të kenë më shumë para dhe më shumë pushime.

Ndonëse stafi i EULEX-it e shpenzon një pjesë të pagave në Kosovë, kjo ka efekt të përgjithshëm negativ sepse kontribuon në rritjen e përgjithshme artificiale të kostos jetësore për njerëzit këtu, që duhet t'ia dalin mbanë me paga shumë më të ulta. Edhe më e rëndësishme, 'kontributi' i stafit të EULEX-it duhet të matet përkundrajt përfitimeve afatgjate nga këto para sikur ato të investoheshin në gjëra për të cilat populli i Kosovës njëmend ka nevojë, si universitete, shkolla e spitale.

EULEX-i kur të bëhet plotësisht operacional do të përfshijë 1.900 ndërkombëtarë dhe 1.100 staf lokal.

Kjo do të përfshijë:

- 1400 policë
- 300 zyrtarë gjykatash duke përfshirë 70 veta në sistemin e burgjeve, dhe më shumë se 40 gjykatës dhe mbi 20 prokurorë. (Çka do të bëjnë të tjerët???)
- 27 zyrtarë ndërkombëtarë doganash deri më tash

Përveç kësaj, ZCN i ka 75 veta staf ndërkombëtar dhe 200 lokale

Së paku për njërin prej shteteve kontribuese në EULEX, shpenzimet vjetore për një zyrtar kuadër janë rreth 111.000 euro. Nëse kjo do të ishte shpenzimi mesatar për 1.900 pjesëtarët e stafit ndërkombëtar, shpenzimi i përgjithshëm i tërë këtij stafi për një vit do të ishte 210,9 milionë euro. Për vitin e parë kjo do t'i shtohet shumës prej 153,75 milionë euro. Ndërkaq pas 16 muajve kjo do t'i shtohet shumës prej 190 milionë euro:

$153,75 + 210,9 = 364,65$ milionë euro për vitin e parë
 $190 + 210,9 = 400,9$ milionë euro për vitet pas 16 muajve

E gjithë kjo do të thotë se EULEX-i do të shpenzojë së paku një milionë euro në ditë.

Kjo shumë e madhe parash, po ta kishte qëllimin vërtet ta ndihmonte Kosovën dhe t'i përmbushte nevojat e popullit këtu, shumë më e mirë do të ishte po të përdorej në investime që do ta ngrisin mirëqenien e qytetarëve të Kosovës, dhe do t'ia hapnin vendit tonë perspektivën ekonomike. P.sh. arsim dhe shëndetësi.

Universiteti i Evropës Juglindore në Tetovë: Shpenzimet vjetore 10 milionë euro (vlerësimet sipas të dhënave për vitin akademik 2007-2008. Të hyrat nga pagesat e studentëve dhe 2 deri në 4 milionë euro prej KE përmes AER bëjnë përafërsisht po aq). Ky universitet i ka 5.900 studentë (përfshirë këtu 620 me korrespondencë) dhe 40 veta staf. EULEX-i shpenzon së paku 35 herë më shumë !

NUMRA TË KRAHASUESHËM

Sodersjukhuset – një prej spitaleve më të mira të Suedisë me Qendrën emergjente më të madhe në Evropë ka buxhet prej rreth 280, 5 milionë euro. I ka 4.070 veta staf, 92.000 emergency patients dhe 52.500 qëndrime afatgjate të pacientëve përgjatë një viti. EULEX-i shpenzon më shumë se kaq !

London School of Economics (2007): Stafi kushton 85,813 milionë funta (rreth 103 milionë Euro). Shpenzimi total 147,544 milionë funta (rreth 178 milionë Euro). (LSE kishte suficit për shkak të pagesave të studentëve.) LSE ka 8.500 studentë (përfshirë 800 me korrespondencë) dhe 2.800 staff (përfshirë 1.320 me orar të shkurtuar).

Buxheti për EULEX-in do të mund të përdorej për:

- Infrastrukturë (rrugë etj.)
- Subvencionin për bujqësinë
- Kontribute të ndryshme për prodhime vendore dhe biznes të vogël
- Bursa për shkollim
- Fonde për riparimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesave publike (postës, çerdheve të fëmijëve, shkollave, spitaleve)
- Pajisje për shërbyesit publikë (pajisje për mjekësi, kompjuterë etj.)
- Fonde për reciklim të mbeturinave
- Qendër kulturore për të rinjtë
- Qendër kulturore për pensionistët
- Arsimit alternativ dhe shkolla profesionale
- Përmirësim të transportit publik
- Parqe
- Përmirësim të qasjes në shërbime publike për invalidët

Shtojcë: Pikat më problematike të Veprimit të Përbashkët të Këshillit të BE-së:

1. Ky Plan fillon duke iu referuar Rezolutës 1244
2. Në pikën (2) të hyrjes ky Plan i quan institucione të Kosovës institucionet “e krijuara në bazë të Rezolutës 1244”. Pra, jo institucionet e bazuara në Kushtetutën e Republikës së Kosovës (ose sepse dihej qysh atëherë se çfarëdo Kushtetute e ardhshme e Kosovës do të jetë tërësisht brenda Rezolutës 1244).
3. Në pikën (3) të hyrjes tregohet se EULEX-i bazohet në një paragjykim të tmerrshëm për neve: “ka nevojë për t’i parandaluar, në bazë humanitare, shpërthimet e mundshme të dhunës, akteve të përndjekjes dhe frikësimit në Kosovë ...”. Mbi këtë paragjykim pika (5) tregon se me 11 dhjetor 2006 është aprovuar Koncepti i Menaxhimit të Krizës dhe për pasojë ‘sundimi i ligjit’ askund nuk lidhet me drejtësinë dhe të drejtën.
4. Pika (14) e hyrjes dëshmon që EULEX-i është mision i BE-së, jashtë BE-së, për BE-në. Ai do të merret me Kosovën ama jo për hir të Kosovës por për hir të BE-së.
5. Neni 3b tregon se EULEX-i është organ ekzekutiv mbi Qeverinë dhe institucionet e tjera të Kosovës.
6. Neni 3d flet për krijimin e bashkëpunimit dhe strukturave koordinuese ndërmjet policisë dhe prokurorisë. EULEX-i, sikurse UNMIK-u, do të sundojë me Kosovën duke sunduar me politikanët e saj përmes dosjeve.
7. Neni 3h thotë që EULEX-i “do të marrë përgjegjësi të tjera, pavarësisht ose në përkrahje të autoriteteve të Kosovës” duke mos i specifikuar ato. Kështu, pushteti i EULEX-it bëhet i pakufishëm dhe tërësisht arbitrar.